



**MINISTRI OLLDASHI
 INSPEKTON PUNIMET E
 NDËRTIMIT TË RRUGËS
 QUKËS-QAFË-PLLOÇË**



**Stolitë e veshjeve
 të Rrajcës, në një
 ekspozitë private
 në Muzeun Historik
 Kombëtar**

Nga Zabit CUKU

**GJEOGRAFI JACQUES
 BOURCART KA NDJEKUR
 RRJEDHJEN E
 SHKUMBINIT**

Nga Zenun FERRO

XHA BAKIU I MOKRËS!

Nga Koço PIHONI

Me mijëra pushues mësyjnë Pogradecin

Janë me mijëra pushuesit që kanë vendosur të kalojnë pushimet këtë vit në Pogradec. Jo vetëm nga qytetet e tjera të Shqipërisë, por edhe jashtë saj vijnë në këtë qytet të bukur për të kalur ditët e nxehta të verës, në klimën e jashtëzakonshme, në mjedisin e pastër dhe ujët e kthjellët të liqenit. Disa turistë kanë preferuar edhe udhët e Mokrës, një pjesë e të cilëve janë parë pranë varreve e lire të Selcës së Poshtme, pranë Urës së Golikut dhe përgjatë luginës së Shkumbinit.



**Polifonia e Rrajcës në
 Festivalin
 Ndërkombëtar të
 Polifonisë "Bylis 2010"**



PENGU I NËNËS

Tregim nga
 Istref HAXHILLARI

URIME PËR POEZITË, ORNELA!

Nga Pëllumb ZADE

**Respekt për shoferin e
 palodhur Guri Korça**

Nga Sami LEKA

DOSSIER

Themeli i Bashkësisë Ortodokse Vllehe të Tiranës (1818-1992) dhe kontributi i mokrarëve

KODIKU I KISHËS SË SHËN PROKOPIT TË TIRANËS

Nga Llazi TONA



Pogradec 1934, Dhimitër Beduli mësues i fesë

Stolitë e veshjeve të Rrajcës, në një ekspozitë në Muzeun Historik Kombëtar

Nga Zabit ÇUKU

Në Muzeumin Historik Kombëtar më 16 qershor 2010, koleksionisti Lulzim Perati prezantoi 24 koleksione të plota stolish nga dhjetë krahina të ndryshme të Shqipërisë, një nga këto ishte dhe veshja e zonës Rrajcës.

Stolitë nga Korça, Çamëria, Rrajca, Mati, Mirdita, Çermenika, Shkodra, Zadrima, Dukagjini, Malësia e Madhe, i takojnë shekullit 19-të, por edhe një periudhe më të hershme. Etnografët dhe studiuesit flasin për elementë të mesjetës së hershme.

Kostumet e grave që vijnë nga familjet e Elbasanit, Krujës, Beratit, kostumi qytetar që vishej në Durrës, Tiranë, Korçë, dhe fustani i Leskovikut me baza argjendi, kapele dhe pandofla. Veshjet ishin aty për të treguar se si rrinin stolitë në to. Për këtë koleksion Lulzim Perati ka punuar për 23 vjet pune, që nga viti 1987. Me rëndësi ishin pasqyruar veshjet për gruan shqiptare. Këto stoli janë siguruar të gjitha duke u blerë nga Perati. Tek kjo ekspozitë shohim se çfarë kanë bërë dhe realizuar artizanët shqiptarë. Në vitet 1700-1800, argjendi ishte shumë i çmueshëm, dhe kishte një vlerësim shumë të madh. Një kostum Rrajce nuk mund ta siguroje më pak se 50-60 Napolona ari., ose në vitet 1970-1980 shkonte deri 300 mijë lek të vjetra. Përgjithësisht gratë kanë përdorur një veshje të bukur dhe të rëndë.

Stolitë e Rrajcës, Mokrës, Labinotit, Gramshit, datojnë aty nga mesi i shekullit 18-të. Nuk mund të flasim për datime të sakta në etnografi, por etnografët këto i nxjerrin afërsisht kohën e lindjes dhe përdorimit të tyre. Burrat kanë më pak stoli dhe kanë një rektor tjetër zbukurimi dhe më të lehtë se gratë. Tek burrat dallojmë



qostekët e armëve, të sahatëve, në disa raste dhe unaza me stoli të veçanta. Nga stolitë më të bukura të burrave ishin ato të armëve, të sahatëve, cigarshtet e pirjes duhanit e tjera.

Tipike e Rrajcës është se kjo nuk shquhet vetëm për këngët dhe vallet e saj të bukura, por edhe për një etnografi të veçantë, ku këtu shquhet për kostumin e bukur sidomos të grave, i punuar vetëm me dorë nga vetë gratë e Rrajcës. Ky kostum ka një shumëllojshmëri veshjesh, i cili ndahet në katër mënyra:

a- Për veshjen e plakave përveç veshjes përgjithshme karakteristike është xhoka e bardhë leshe, pashtemalli ose përpase e zezë, si dhe shaminë e leshtit e kuqe.

b- Në veshjen e grave dominon qesikja, jeleku me rupa, pare, raftet, rripin me xhixha ndriçuese, si dhe shaminë e leshtit të kuqe.

c- Nusët e reja kanë në veshjen e tyre kësulën, cullufet, me 7-10 rupa ari, argjendi ose flori, xhyben ku dominon e kuqja,



shamitë e bardha dhe të kuqe, gjerdanin e gushës me rruaza, rafte dhe rupa sermi, ari deri në 100 copë. Shamia e kokës e shoqëruar me tel e qëndisur me fije ari e cila varet mbi cepin e kësulës dhe mbi shpatulla.

d- Vajzat në veshjen e tyre të veçantë kanë xhokën, rripin me xhixha, jelekun, me sumbulla, të shoqëruar me gajtan e me fije të qëndisura ari.

Një kostum kompleks i gruas së Rrajcës përbehet:

Kësula e cila mbahet në kokë, e veshur me xixa e rruaza shumë ngjyrshë, me rupa, pare të vogla prej ari, argjenti, ose flori deri 10 copë të varura mbi ballë, shami prej leshe, me cepa në të dy anët e fytyrës, dy varse të qëndisura me rruaza shumë ngjyrshë që varen në të dy anët. Nën gushë varet një gjerdan i qëndisur, një

varse me rupa, para të vogla prej ari, argjendi ose flori, këmisha e bardhe, e gjerë me pala, 15-20 centimetër poshtë gjurit. Qesike prej leshe, e qëndisur me fije gajtani me trashësi të ndryshme, raftet me rupa, pare të çmuara në pjesën e përparme në të dy anët e gjoksit. Në mes kapen me një pjesë metali të çmuar me kapak. Është e qëndisur nga metal punuesit me shumë kujdes, me yll, shqiponjë ose shenja të tjera. Mbi të gjitha vishet një xhybe e gjatë sipas trupit dhe moshës. Kjo është më e kostueshmeja dhe më e bukura për gratë e çdo moshe.

Çorape të gjata prej leshe, të punuara me shumë llojshmëri ngjyrash. Në këmbë kanë veshur këpucë të zeza, të kuqe, opinga lëkure të punuara bukur dhe të lidhura me gjalma shumëngjyrësh.

Kostumi vishet në dasma, festa dhe ceremoni të ndryshme festive.

Pas viteve 1990-të si kudo edhe në Rrajcë filloj të përhapesh më shumë dëshira për një veshje të vjetër kombëtare dhe për të ruajtur më shumë traditën e krahinës. Ishtë dëshira e secilit që të kishite një kostum gruaje po dhe burri në sh-tëpi, kishte dëshirë që gocën ose djalin ta martonte të veshur më kostumin e Rrajcës pavarësisht nga mundësia ekonomike që kishte. Sot gati çdo gjë është krejt ndryshe edhe për vajzat e vogla kanë prodhuar kostume karakteristike. Kjo që shohim në foto është një vajzë 10 vjeçare Alessia Cuku dhe jeton në Bolonja të Italisë kur ka ardhur në Rrajcë ka veshur një pjesë të kostumit karakteristike të Rrajcës.

Ky kostum është pëlqyer dhe vlerësuar shumë nëpër festivale ndër vite, është duartrokatur e vlerësuar në Moskë, Sofje, Kinë, Dizhon të Francës duke marrë gjerdanin e artë, Stamboll, Agrixhento dhe Arbëreshë të Italisë, Shkup, Ohër, Strugë, Tetovë, e Prishtinë. Duke marrë shkas nga kjo ekspozitë, falënderoi koleksionistin Lulzim Perati për punën dhe përpjekjet e bëra, përsëritës dhe uroi e dëshiroi që të gjitha vajzat e Rrajcës të vishen me kostumet e tyre të bukura ashtu siç janë vetë të bukura dhe punëtore.



Reth një vit më parë, bashke me disa kolegë, morëm rrugën e gjatë, por të dashur për në fshatin Velçan, ku promovojmë libri i dytë i shokut tonë, Haki Balliut, "Rënia e Pelionit". Të them të drejtën, surprizat e këtij udhëtimi qenë të shumta. Gjëja më e pakëndshme ishte vetëm rruga e katandisur në një gjendje shumë të keqe, por për të tjerat, patëm një kënaqësi të veçantë.

Mokra, e sidomos Velçani, është një vend shumë i bukur, që i ngjan një peizazhi të qëndisur me mjeshtëri nga një piktor i madh, por më e bukura janë njerëzit e mrekullshëm që jetojnë atje. Ata, me mikpritjen, humorin, pse jo, edhe me intelektin e tyre të spikatur, të krijojnë një mjedis gazmor që të le mjaft mbresa.

Ajo që më entuziazmoi më tepër ishte bashkëbisedimi në sallë me intelektualë, drejt-

URIME PËR POEZITË, ORNELA!

tues të komunës, mësuesit, e sidomos me një grup të rinjsh e nxënësish të shkollës. Të bëhej zemra mal, kur dëgjoje këta të rinj që secili më vete, zbërthente komentonte me shumë talent pjesë nga libri "Rënia e Pelionit", të gdhendur me mjeshtëri nga autori. Kjo na beri optimiste se këta të rinj, do jenë ata që do e çojnë më tej vullnetin tonë për të mos "harruar" të shkruajmë e të flasim për Mokrën tonë të dashur, e mesa duket nuk do të jemi të zhgënjyer.

Në numrin e kaluar gazeta jonë, "Mokra", botoi vargjet e bukura të njerës nga pjesëmarrëset e atij takimi, nxënës Ornella Torra. Të them të drejtën, këto vargje i kam lexuar para të gjitha shkrimeve të tjera dhe qenë një surprizë e bukur për mua. Ornella në këto rreshta i këndonte menjë pasion rinor dashurisë, pa të cilën jeta nuk do kishte kuptim, i këndonte bukurisë, për të cilën nëna natyrë është treguar mjaft bujare. Ornella nuk harron t'u këndojë as flokëve të thinjura të nënës, që aq shumë dinë ta duan e ta nderojnë djemtë e vajzat mokrare.

Ja pra, për këto vargje të bukura kënaqemi dyfish ne që jemi të larguar nga vendi ku kemi lindur, për të cilin ruajmë respekt e dashuri. Si përfundim, do uroja autoren për krijimtarinë e saj, e besoj se kjo do jetë vetëm fillimi i një pune të madhe letrare. Le të shpresojmë se Ornella do të ndiqet edhe nga të rinj të tjerë.

Pëllumb Zade, kryetar i shoqatës "Pelioni"

NGUSHELLIME

P ara disa ditësh, me një keqardhje të madhe, mora vesh për ndarjen e parakoheshme nga jeta të intelektualit Klime Tola, lindur në fshatin Potgozhan, e banus ne qytetin e Pogradecit.

Me Klimen jemi njohur si dhe kemi bashke punuar para viteve 90, ku ai punonte si kryellogaritar në ish-kooperativën bujqësore Trebinjë. Klimja ka qenë një njeri punëtor, i ndershëm, me karakter të lartë mokrari, që dinte të punonte e të komunikonte me çdo njeri. Ai punonjesit nuk i vleresonte

sipas propagandës politike të kohës, por si ata ishin realisht, e kjo e bënte Klimen të dashur me të gjithë, duke krijuar një rreth të gjere shoqëror qeverlesonin cilesite e tij.

Do dëshiroja që nëpërmjet këtyre rreshtave, në emër të shoqatës e te gazetës "Mokra", si dhe në emrin tim personal, të ngushelloja familjen, si dhe të afermit e të ndjerit Klime Tola, për këtë humbje të madhe të njeriut të tyre të dashur. ZOTI E PREHTE NE PEQEN E PERJETESHME.

Pëllumb ZADE

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"

Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës

Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.poradeci.com/mokra



DEGËT, KUOTAT E TARIFAT NË UNIVERSITETIN E KORÇËS NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

Qeveria miratoi më 7 korrik 2010 numrin e studentëve që do të ulen në auditorët në vitin mësimor akademik 2010-2011, të universitetit të Korçës

dhe të universiteteve të tjera. Më poshtë po paraqitim, numrin e studentëve të universitetit të Korçës, dega, kuota dhe tarifën.

Universiteti i Korçës	Kuota	Tarifa
Dega		
Histori- gjeografi	50	12.000
Gjuhë- letërsi	60	12.000
Anglisht	60	12.000
Frëngjisht	40	12.000
Cikli i ulët	40	12.000
Cikli i ulët parashkollor	30	12.000
Matematikë-informatikë	120	12.000
Teknik- informacioni	120	12.000
Matematikë-fizikë	60	12.000
Filozofi-sociologji	80	12.000
Ifermeri	100	12.000
Mami	40	12.000
Financë	100	12.000
Turizëm	80	12.000
Turizëm , (Pogradec)	60	12.000
Marketing	100	12.000
Agrobiznes	60	12.000
Hortikulturë	60	12.000
Agro-ushqim	70	12.000
Teknologji e prodhimit bimor	60	12.000
Totali	1580	

Mbjell kanabis, arrestohet kryeplaku i Hondishtit

Një tjetër arrestim në komonën e Trebinjës. Pas arrestimit të kryekomunarit, muajin e kaluar, është arrestuar edhe kryeplaku i fshatit Hondisht. Policia e Korçës dhe komisariati i Pogradecit kanë vënë në pranga kryeplakun e fshatit Hondisht, komuna Trebinjë me akuzën e kultivimit të lëndës narkotike në oborrin e banesës së tij. Në 7 korrik policia ka arrestuar shtetasin Anvi Pançe, në Pogradec, pasi në bahçen e tij është gjetur një sasi lëndësh narkotike kanabis sativa e mbjellë.

Sipas burimeve zyrtare të policisë, bëhet e ditur se kryeplaku i fshatit kishte mbjellë 26 rrënjë kanabis në oborrin e banesës së tij. Për bashkëpunim me kryeplakun mësohet se është arrestuar edhe shtetasi Erjon Hysa, banues në të njëjtin fshat, të cilit i janë gjetur 46 rrënjë kanabis. Në gjendje të lirë po

ndiqet penalisht një person i tretë, shtetasi Mevlan Gjika.

Të pranishëm në një dasmë mokrari

Në datën 26 dhe 27 qeshor 2010 gjithë hapësira e fshatit Slatinë u mbush me tinguj muzike dhe jehonë këngësh. Bëhej dasëm te Livan Balliu. Për 24 orë orkestrantët me drejtues Gjergji Bibën nga Velçani dhe Pëllumb Kullolli nga Slabinja qëndruan përpara veglave të tyre. I pari luante e këndonte në organo, i dyti në klarinetë. Nga fryma e gish-tat e tyre formohen te gjitha meloditë nga këngët popullore të Mokrës e gjer ato të Shqipërisë së Mesme. Madje në repertor ata kanë edhe këngë nga muzika karakteristike e Pogradecit dhe të huaja. Kush ka mall t'i dëgjojë e ka dëshirë të vallëzojë, le t'i ftojë në dasmë. Ata janë të gatshëm, madje me një pagesë simbolike. Livan Balliu martonte mbesën e dytë, Shegën. Ishte dasmë e rrallë, e madhe me 150 dasmorë, burra e gra bashkë ne tavolinat e shtruar mbi lëndinë, pranë shtëpisë. Të mrekullonte harmonia e te pranishmeve, të ftuar e të pa ftuar, miq e bashkëfshatar të Livanit, vijnë e urojnë, ulen e pinë, këndojnë e vallëzojnë. Nëse muzikantët të duken artistë të vërtetë, po aq edhe dasmorët. E kur hyn nusia në valle, rrethi

INSPEKTIMI NË PUNIMET E NDËRTIMIT TË RRUGËS QUKËS-QAFË-PLLOÇË

Midis shumë projekteve që përfshihen në ndërtimin e rrugëve është edhe projekti që përfshin segmentin e rrugës nga kryqëzimi i Ersekës deri tek varrezat e qytetit të Korçës, i njohur si Unaza Veriore. Ky segment është inspektuar nga Ministri i Punëve Publike dhe Transporteve, Sokol Olldashi më datën 8 korrik 2010. Ky projekt kap vlerën e 137 milion lekëve. Segmenti i përfunduar i unazës i bashkëngjitet 4 lotëve të tjerë të cilët kanë përfunduar më parë. Ndërkohë, kreu i Mistrisë së Punëve Publike dhe Transporteve ka ndaluar dhe ka inspektuar punimet edhe në segmentin Qafë-Thanë-Lin-Pogradec, si dhe atë Qukës-Qaf-Plloçë, për të parë ecurinë e punimeve në ndërtimin e këtyre rrugëve. Olldashi u shpreh mbi rëndësinë e ndërtimit të këtyre rrugëve, dhe impaktin pozitiv që do të japi përfundimi i tyre. "Siç edhe duket, po marrin pamje ndërtimi i kilometrave të para të rrugës, Qukës-Qaf-Plloçë, një segment i ri i cili shkurton më se 30 minuta kohën e përshkrimit të interarit drejt qytetit të Korçës" tha Olldashi gjatë inspektimit të punimeve në këtë segment.

GJEOGRAFI JACQUES BOURCART KA NDJEKUR RRJEDHJEN E SHKUMBINIT

Nga Zenun FERRO

Gjeografi e etnografi francez Jacques Bourcart, në vitet 1930-të, për tre vjet radhazi, ka ndjekur rrjedhjen e Shkumbinit. Lumi Shkumbin me gjatësi 181 kilometra, rrjedh nga malet e Mokrës, ai kalon në shumë rrethe si Pogradec, Librazhd, Elbasan, Peqin, Lushnjë, Kavajë dhe derdhet në detin Adriatik. Francezi Jacques Bourcart, shkroi se "shqiptarët kanë një frymë perëndimore, ata janë të gjallë e kuriozë, të gëzueshëm, dhe të hapët në miqësi. Për antropologët, ata duhet të jenë specia më e bukur njerëzore në botë. Veçanërisht nëpër male të bie menjëherë në sy bukuria fisnike e burrave," (Gazeta "Milosao,, 6 qershor 2010)

Edhe gazetarja franceze, Fercop dhe Leslay, që vizitoi Shqipërinë në vitet 1936, si dikur Durham, e dashuruar aq shumë pas shqiptarëve, udhëtonte në zbulim të traditave, të mikpritjes dhe vitalitetit të këtij kombi, siç do shkruante ajo: " shqiptarët janë pasardhësit e drejtpërdrejt të pellazgëve të vjetër. Raca e tyre para së gjithash është e fisme. Një tip shtatlartë, krenar, dinjitoz dhe më i bukuri që mund të shohësh pas gjeorgjianëve, me të cilët ngjasojnë".

Bukuria e grykës së Mokrës, etnografin francez Jacques Bourcart, e ka mahnitur. Burimi i lumit Shkumbin vjen nga malet e Mokrës, me ujë të pastër, dhe futet thellë në gryka të bukura. Shkrimtari Miltiadh Davidi shkruan: "se natyra edhe vetë i fshihet pjesët e bukura,, në një poezi në vitin 2009. Ai shkruan se gratë këtu në Mokër, "m'u dukën

tepër të bukura, por ato janë pasionante".

Gjatë udhëtimit konstatova se Mokra, është një krahinë mjaft e pasur me burime natyrore, mushkëritë mbushen me ajër të pastër, dhe sytë me gjelbërimin e pafund në të dy anët e Shkumbinit.

Për Mokrën nga largësia e viteve na vijnë histori të lashta, që lidhen me këtë emër. Historia e kësaj krahine është e vulusur nga dëshmitarët e kohëve, në dokumente, në objekte të lashtësisë, në kalatë, në rrugët e vjetra, këto të dhëna e kanë bërë shumë të njohur Mokrën.

Francezi Jacques Bourcart, i ka lënë mbresa Mokra, mokraret janë njerëz fisnikë, të çiltër, të dashur, gazmorë dhe të mençur. Ato trashëgojnë cilësi të rralla njerëzore si: mikpritja, bujaria, organizimi i mirë i ceremonive, dasmave, apo rasteve të fatkeqësive familjare etje. Ndjaj kam simpati për këtë krahinë e për njerëzit e saj bujarë, punëtorë, të këngës, valles, të konakut....,

Antonio Baldaci, studiuesi i shekullit 19-të, eksploroj për 25 vjet Shqipërinë, Mokrën, e kurorën e Valamarës, eksploroj e identifikoi mbi 300 bimë mjekësore. Në librin e tij të vitit 1895 ai thotë: " Një shtet i fuqishëm do të kishte shpallur këtë vend, "Park kombëtar medicinal,.. Në këtë botim ai shkruan se ky popull nuk jeton dot pa armë, pa pushkën. Ka qënë kryeministri italian me origjinë shqiptare Kripsi, që financoi për një kohë të gjatë ekspeditë me qëllim njohje për Shqipërinë(Koço Pihoni, gazeta "Mokra ,, Nr.7, viti 2010).



se i dehin ëndrrat e së ardhmes. Mbase ëndërronin të kishin të njëjtin fat të lumtur si atë të Shegës. Të gjithë gëzojnë. Më shumë nga te gjithë lumtur ohet nëna e nuses, Lavdia, me gjithë petkun e brengës që e mban veshur. E bija Shega, si yll i bukurisë, doli nuse veshur me të bardha, me pamje dhe delikatesë prej artisteje. Për krahu e mbante xhaxhai Ferziu dhe i vëllai Gëzimi. Ky është më i vogli i gjashtë fëmijëve por tregohet i rritur se mbi kokë ka pesë motrat, kështu e lyp zakoni dhe burrëria mokrare.

Urojme Shegën dhe bashkëshortin Mirjan Alla të kalojnë jetë të lumtur e të trashëgohehen e të gëzohen. Gjithashtu përshëndesim muzikantët Gjergjin dhe Pëllumbin që i dhanë dasmës jetë dhe gëzim.

Me respekt Haki BALLIU

URIM

Jam Dibran. E përgëzoj të gjithë stafin e gazetës "Mokra" për trajtimin që bëni për mbrojtjen e vlerave kulturore të krahinës tuaj, Pogradecit dhe në shkallë kombëtare. Ju uroj të keni gjithmonë suksese sepse dhe unë kam botuar njëherë në gazetën MOKRA.

Shëndet ju dhe familjet tuaja!
Ju uron Nazmi Bitri!

Themeli i Bashkësisë Ortodokse Vllahë të Tiranës dhe nismëtarët e saj (1818-1922)

Nga Llazi TONA

KODIKU I KISHËS SË SHËN PROKOPIT TË TIRANËS

Kodikët e Shqipërisë përbëjnë një pasuri monumentale të kulturës dhe mendimit njerëzor. Njohja e vlerave të shumëfishta të tyre është objekt dhe detyrë e antropologjisë kulturore. Kodikët janë libra në dorëshkrim që përmbajnë shkrime të shenjta: bibla, ungjillorë, gjeografikë. Ato konsiderohen si dëshmi më të hershme të historisë së Shqipërisë nëpër treva shqiptare si: Berati, Vlora, Fieri, Durrësi, Elbasani, Tirana, Korça, Erseka, Përmeti, Gjirokastra, Saranda etj.

Në shtatë kodikë të rrallë dhe unikalë shkruar në pergamenë që kanë arritur deri në kohë moderne dy prej tyre gjenden në Shqipëri. Kodikët e purpurt të Beratit kronologjikisht përfaqësojnë një prej varianteve më të vjetra të *Besëlidhjes së Re* dhe renditet në 3-4 më të hershëm në botë (SHSB).

Është Berati ai që mori rolin e një kryeqendre administrative dhe kulturore historike kishtarë. Ai shquhet për numrin më të madh të kodikëve. Edhe sot ai shquhet përmbi 75 kodikë që ruhen në arkivat shtetërore.

Berati është një nga qytetet më të lashta të Shqipërisë dhe kryeqendra e Myzeqesë. Nga regjistrimet që ka bërë administrata turke në fillim të shekullit XX del se "Në sanxhakun e Beratit kanë banuar 10125 arumunë. Në atë kohë e gjithë Shqipëria kishte rreth 750000 banorë". Gustav Weigand (1860-1930) që për të studiuar arumunitetin shkon në Shqipëri dhe thotë "Nga 12000 banorë që jetonin në Berat 9000 ishin vllahë dhe 3000 shqiptarë" (Kares). Që në vitin 1864 Perandoria turke lejoi hapjen e shkollave vllahe në të gjitha vilajetet e saj. Gjimnazet u hapën në: Manastir, Selanik, Janinë dhe Berat.

Një ndërthurje të problematikës ungjillore me atë laike është dhe kodiku i Voskopojës. Në shek. XVIII atje u hap dhe Akademia, kishte dhe shtypshkronjën e tyre ku botonin dhe libra në gjuhën vllahë. Në qytetin e Shqipërisë së Jugut dikur i banuar thuajse 100% vllahë në XVIII kishte rreth 6000 banorë. Voskopoja njihet si vendi i 40 kishave krishtere ortodokse. Jo më kot quhet "Mbretëresha e kulturës dhe arsimit shqiptar". Kodiku i Voskopojës ka lidhje me emrin e Teodor Anashtas Kavaliotit, nxënës Evgjëni Vulgarasit, arvanitas i Greqisë i cili ishte bërë një dijetar nga më të shquar të kohës në Ballkan. Leksionet e Vulgarasit në Akademinë e Janinës dhe veprat e botuara prej tij u përhapën në gjithë Europën. Ai është përkthyesi i disa veprave të Volterit, predikoi dhe teorinë e filozofit anglez, Lokut, e cila justifikonte të drejtën për restaurimin mendor dhe shoqëror.

Esnafti i bakërshinjeve të Voskopojës e dërgon Kavaliotin me shpenzimet e veta të mëson në Janinë ku Vulgarasi jepte mësim në kolegjin "Marusia".

Në vitin 1750 Kavalioti në moshën 22 vjeç u kthye në Voskopojë dhe u bë rektor i Akademisë. Ai atje ka dhënë mësimet e gramatikës, filozofinë, teologjinë dhe shkencat e natyrës.


Nga veprat të hartuara prej tij si tekste mësimore janë ruajtur si dorëshkrime në gjuhën greke si: "Logjika" (1767); "Fizika" (1752) dhe "Metafizika" (1767). I pari fillon me shënimin "Traktati i Logjikës". Më 1760 boton në shtypshkronjën e Voskopojës (doktor i së cilës ishte Mihal Shiptakani) veprën dinjitoze "Gramatika" në gjuhën greqishtë që ia kushtoi Josifit, patrikut të kishës së Ohrit me origjinë voskopojare. Më 1770 botoi në Venedik librin "Proporiori" që përmbledh dhe një fjalor trig-



Pogradec 1934, Dhimitër Beduli mësues i fesë



Pogradec 1934, Dhimitër Beduli me krerët e Kishës



juhësh greqisht-vllahisht-shqip me 1170 fjalë. Pikëpamjet filozofike të Kavaliotit u formulua nën ndikimin e filozofit të lashtë grek Aristotel. Më 1774 u ribotua në Venedik gramatika e greqishtes me 10 vjersha të botuar nga mësues që e quanin veten "nxënës të Kavaliotit".

Kodiku i Voskopojës në përmbajtje lidhet me tekstet shkollore. Në to përfshihen këto tema shkencore: Mbi fillimet e fizikës, ndarjen të saj; Bazat e kimisë; Mbi hapësirën, mbi natyrën, mbi vendin e palëvizshëm; mbi nishjen dhe lëvizjen në hapësirë; Trupat e nxehtë dhe trupat e ftohtë; Lagështia në përgjithësi dhe lagështia në banesa; Lëvizja dhe qëndrimi; Mbi elementët e natyrës, toka, uji, drita; etj. Në shkrimin e mëposhtëm do të mundohem të trajtoj: Kodikun e Kishës së Dëshmorit të Madh Shën Prokopit të Tiranës (1818-1922).

Kodiku i Tiranës përmban të dhëna të vlefshme e të pasura për zhvillimin shoqëror, ekonomik, arsimor, kulturor dhe fetar të Bashkësisë së Tiranës nga fillimi i

shekullit XIX^{te} dhe çerekshekullit të XX^{te}. Sipas shënimeve të para të kodikut del se në fillim është përdorur si regjistër ku epitropët herë pas herë verifikonin të ardhurat dhe shpenzimet të kishës, shënonin gjendjen e të hollave që ajo kishte në fakt në regjistër.

Regjistri përdorej dhe për shënimin e emrave të dhurueshme dhe të bamirësisë të herëpashershme të bashkisë që kontribuonin në ndërtimin dhe zbulimin e kishave e sidomos të shkollës. E para listë e kësaj natyre e regjistruar në këtë kodik është ajo e vitit 1818^{te} për ndërtimin e kishës e Shën Prokopit të Tiranës. Le të konkretizojmë me ndonjë nga ato kontribute që ishin dhe nismëtare të theme- limit të Bashkësisë Ortodokse të Tiranës.

Faqe 3. Viti 1818. Ndihej për Kishën e Dëshmorit të Madh Shën Prokopit të Tiranës.

Dhuruan
At Agathanjeli gr. 100. I përjetshëm kujtimi
Nasi Voilla gr. 250 I përjetshëm kujtimi
Nishku i Lipit gr. 150 I përjetshëm kujtimi

Mitri Thanasi gr. 150 I përjetshëm kujtimi
Jani Tërbo gr. 100 I përjetshëm kujtimi
Miha Belloit gr. 50 I përjetshëm kujtimi
Goga Stamati gr. 50 I përjetshëm kujtimi
etj.

Faqe 2

1819 shkurt 16^{te}

U gjetën të holla të kishës që numëruan dhe janë:

gr. 541

1820 shkurt 8^{te}

Bëmë llogari me epitropin

U gjetën gr. 640

Edhe të tjerë gr. 140

Për 2 vjet 1829 gr.

Faqe 6^{te}

Naun Zgalla (nga Llenga) gr. 50 I përjetshëm kujtimi

Dhimo Zgalla (nga Llenga) gr. 50 I përjetshëm kujtimi

Todo Koja (nga Niça) gr. 50 I përjetshëm kujtimi

Miha Janku (nga Niça) gr. 50 I përjetshëm kujtimi

Faqe 6^{te}

Oxhaku i kazanxhinjve, gr. 400 I përjetshëm kujtimi

Oxhaku i kallainxhinjve gr. 250 I përjetshëm kujtimi

Rusha e Jana Xhumarës dhuruan një qingj

- I përjetshëm kujtimi.

Mbajtja e llogarive nga epitropët në formë të përshkruar vazhdon për vite me radhë. Në kodikun e Tiranës është hedhur më vonë (1875-1876). Lista e ndihmëtarëve për ndërtimin e një kishë tjetër ajo e ungjillizmit për afër saj dhe shkolla ortodokse. Kodiku është shkruar në gjuhën greke. E theksojmë këtë se në kohën e pushtimit turk, gjuha greke ka qenë gjuha e kishës, arsimit dhe e kulturës pothuajse në të gjithë popujt ortodoks të Ballkanit. Në kodikun e Tiranës takon rrallë terma vllahe. Le të konkretizojmë disa nga ato terma:

"Nga Fjalori konvencional

Emra shtetërore

Pexurrosh = Flokëkuq = Rusia

Lingura = Luga = Inglitera

Franca = Gjethe = Franca

Këtha = Breshka = Italia

Shorku = Miu = Austria

Limba sepsëra = Gjuha e hollë = Greqia

Cërusha = Opinga = Serbia

Groso = I trashë = Bullgaria

Tëjatllu = I prerë = Turqia

Limba Nostre = Gjuha jonë = Vllah / arumen etj.

Nga viti 1834 e këtej kodiku i Tiranës është i pasuruar dhe me shënime të tjera. Në të figurojnë të regjistruara procesverbale të herëpashershme të Mbledhjeve të Përgjithshme të Bashkësisë ortodokse të Tiranës të firmosura prej titullarëve të Mitropolisë së Durrësit apo prej të deleguarve të tjerë dhe anëtarëve të Dhimo-gjerondisë së vendit me tematika të tyre që zakonisht ishte:

Shqyrtimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve të kishës që kishte të bënte me vetë jetën e bashkisë sepse në kohën e pushtimit turk strumbulluan rreth të cilit vërtitej jeta e çdo Bashkësie Ortodokse ishte kisha.

Detyrat që atyre u dërgonin lidhur me shkollën dhe ecjen e saj përpara sepse shkolla siç del nga të dhënat e kodikut përbënte kujdeset e tyre të para.

Zgjedhja e epitropëve të rrënjës e probleme që lidhnin herë pas here në gjirin e saj.

Kodiku është bërë i njohur përherë të parë në botën shkencore nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX^{te}. Është përkthyer në vitin 1997 nga teologu Dhimitër Beduli në gjuhën shqipe, njeriu që punoi një jetë të tërë (mbi 60 vjet) vetëm për një qëllim për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë së cilës i dha një shtysë në ekzistencën dhe zhvillimin e saj. Ai ishte pajisur me një kulturë të gjerë evropiane. Mbas mbaron shkollën plotore në vendlindjen e tij vazhdon gjimnazin e Athinës dhe më pas kryen studimet e lar-

(vijon në faqen 5)

(vijon nga faqja 4)

ta për teologji mbasi përfundon atë shkon për t'u specializuar për muzikën bizantine në Besarabi. Fill pas këtij specializimi emërohet mësues feje të krishterimit ortodoks në Pogradec ku krijon atje dhe korin e kishës. Më vonë pedagog në seminarin kombëtar ortodoks "Apostul Pavli" në Tiranë. Është autor i shumë librave ortodokse etj.

Në kodikun e Tiranës jepen të dhëna lidhur me jetën e Bashkësisë Ortodokse të Qytetit të Tiranës si fiset: Voilla nga Voskopoja; Nishku, Sheguna nga Grabova; Fendiku, Shundi, Pano, Zgalla nga Lenga; Koja, Janku, Prendi, Mara nga Niça e Mokrës; Hobdara, Heba, Jorganët, Misha, Çoba, Topulli nga Belica; Duniba nga Bllaca; Xhumara nga Elbasani etj.

Një numër i madh studiues evropianë kanë përdorur thellësisht dhe gjerësisht kodikun e Tiranës në fushën e linguitikës, etnografisë, etno-kulturore mbi origjinën dhe historinë e vllahëve në mënyrë të veçantë në Gadishullin Ballkanik.

Mjaft nga ato thonë se "Vllahët janë superrumunë". Bie në fakt që këta studiues janë shumë të përafërt midis tyre me tezat që hedhin. Tezat e tyre mbizotëruese është ajo me origjinë trako-ilire.

Sipas E. Thumnan (1774) "Shqiptarët dhe vllahët janë popuj të vjetër të Evropës" (Historia e Ballkanit).

Ndërsa antropologu grek A.M. Poulinas ka pohuar se vllahët janë një popull paraindoeuropian."

Gustav Weigand gjerman është më i dëgjuar për historinë, etnografinë, kulturën dhe dialektin, vllah jo vetëm në Evropë por dhe në botë. Ai është vllah nga Taipei i Gjermanisë dhe ka ngritur në Gjermani institutin e gjuhës vllahë. Ka botuar dhe publikuar një varg librash në fushën e linguitikës vllahë.

Në fund të shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX bëri studime të hollësishme për dialektin dhe terminologjinë vllahë në Bashkësinë Ortodokse të Tiranës. Elementet kryesore linguitike ai i mblodhi nga kodiku i Tiranës.

Le të përmendim ndonjë frazë apo emër nga ky kodik të nxjerrë nga ai vetë: "Va s'planga nipa e sit" (do të qajnë nipër); "La herasimu," (të gëzohemi); "pri (alli) mnvesta" (mbi kalë nusja) etj. Nga kodiku i Tiranës ai mblodhi një numër i madh emrash, mbiemra, folje, përemra etj.

"biserka" (Kishë); "Casa" (Shtëpi); "bautura" (Pyl); "berbechl" (dash); "nvesta" (nuse) "fratelo" (vëlla); "limba" (gjuhë); "Capra" (dhi); "muliera" (grua); "pana" (bukë) "un" (një); "vaca" (Lepe) etj.

Elementet gjuhësore të nxjerra nga kodiku i Tiranës ai i krahasoi dhe me ato që kish grumbulluar nga: Epiri, Thesalia, Maqedonia, Bosnje-Hercegovina duke parë që ato terma ishin të përafërta mori për bazë dialektin vllah të Bashkësisë së Tiranës.

Edhe akademiku Thoma Kupiduni për botimin dhe publikimin e një vargu të madh librash për dialektin vllah ka marrë si bazë kodikun e Tiranës. Një nga ato është libri "AROMAN DIALEKTI," AROMAN Studii, LINGVISIC". Pjesët kryesore të këtij libri madhor. – Dialekt arumen. – Vendi i dialektit arumen në gjuhën rumune. – Fonologjia. – Morfologji etj. Termat kryesore për hartimin e këtij libri u mor vetëm nga kodiku i Tiranës.

Nga fundi i shekullit 9^g gjatë udhëtimit nëpër Shqipëri viziton Tiranën studiuesi austriak Georg Von Hahn i cili në bazë të të dhënave që mblodhi dhe vëzhgoi personalisht në Bashkësinë Ortodokse vllahë të Tiranës, ai nxori si konkluzion se nga 2000 shtëpi që kish Tirana, 100 për qind kishin Bashkësinë Ortodokse vllahë:

Baralearuën një studiues rumun në një vepër e botuar prej tij më 1912 thekson se në Tiranë kishte 150 familje vllahë.

Edhe Nikolla Jorgo në një libër të botuar prej më 1919 jep shifra 2000 dhe nga regjistrimet e bëra në atë kohë dilte se 900 banorë të qytetit ishin vllahë.

(vijon në numrin e ardhshëm)

RRËFIME/ "TË NJOHIN E VLERËSOJMË FOLKUN E KRAHINËS TONË"

Xha Bakiu i Mokrës!

(Material në ndihmë të fjalorit erotik të shkrimtarit "pusht" Edmond Tupja! Emisionit "Portokalli" në Top Channel dhe emisionit "Zona e Lirë" të Arjan Çanit!)



Nga Koço PIHONI

Nëqoftëse do të njohësh traditat e vlerat e një populli, shko kërkoi se do t'i gjeshe ato të ruajtura në fshat", - kjo thënie ka brëndë shumë të vërteta për të gjithë popujt.

Unë e xha Bakiu!

Janë me dhjetëra e dhjetëra herë të "pjekurat" takimet për disa vite me radhë me atë burrë të rrallë të humorit e të traditës mokrare. Sot ai, për mua duhet quajtur, pasuri, vlerë, "monument kulturor" i asaj krahine me ata njerëz punëtorë, trima, bujarë, me humor e të mençur. Në këtë shkrim portret do ta tregoj për një nga më kryesorët, xha Bakinë e Kalivaçit.

Për disa vite radhë takohesha, gati çdo të hënë gjatë verës, në orën 7-7. 30 në vendin e quajtur Ombell, mbi fshatin Kalivaç apo nën ato livadhet e Potgozhanit, tek kroji i Bobishtit. Unë shkoja për në Dunicë, ndërsa ai ngjitej në ato livadhe të kulloste lopën e të bënte dhe nja dy krah gjeth haishte, sa për të mos e ulur bosh e që t'ia vinte në grazhd atij bir gomari! Dhe si përhëndosheshim e i jepnim dorën njëri-tjetrit, uleshim e këmbënim nga një duhan me xha Bakinë. Ai zakonisht e pinte duhanin me çibuk, por aman e mbante edhe një defter letra në kuti për mikun. Kishte një qese prej lëkure në të cilën mbante takëmet: gurë prej stralli, masatin dhe eshkën më të mirë që mbante me erë shëronjëse e që të kënaqte vërtetë, takëme që shërbenin për të shkrepur e ndezur çibukun. I mbante të lidhura e varura në qostek të jelekut prej shajaku të cilin nuk e hiqte as në dimër e as në verë.

Unë i jepja nga ato cigaret e hekurosura "Partizani", por shpesh dridhja dhe unë një cigare nga ajo kutia e fanfonit të xha Bakiut. Bëja jo vetëm për kënaqësinë e "artin" e së dredhurit, aromës së ndezjes me eshkë, por më shumë për lezetin e muhabeteve që bëja me xha Bakinë. Ai ishte natyrë e gjallë, që nuk rinte i heshtur, nuk përtonte por fliste vazhdimisht. Më tregonte një radhë "për atë mot, kur i vdiq babai". Ai thoshte se babai i tij kish hatër shumë e nuk mbet njeri pa vajtur, le nga fshati, por u shkull e tërë Mokra, Gora e Poradeci. Për ditë të tëra, pas vdekjes, nuk mbyllej dera, hynin e dilnin për të pjekur.

"Unë, o doktor i xhanit, dajandisa deri më ditën e tretë, pasi e vumë babanë në dhe, duke pritur e përcjellë shokë e miq. Po pastaj nuk po ndiehesha mirë. Më dukej sikur kisha një lëmsh të madh këtu në bark, që sa vinte e po më ngjitej lart të më zinte grykën. Po më vështirësohej frymëmarrja dhe unë thashë me vete "ika më babanë, vdiqa kaq e pata edhe unë!" Thëres grua e i them, se po shkoj në mal se plasa, ajo më thotë: "More burrë, jak në vete, konaku plot me njerëz, ti mos

luajte nga mëndë?" Mirë, mirë, i thashë. I hipa mushkës e u nisa drejt e në shpella, lart në mal. Futem cazë si thellë e ia mora me të kënduar, me te butë si fillim e më pas ia mora me sa më hante guçma, aq sa oshëtiu tërë mali. Atëherë u çirova, shpëtova se për Zotin që është një, unë do isha harruar sot, do t'i kisha shkuar pranë babait! E që atëherë u bënë 30- 40 vjet të shkuara, asaj shpelle, "Shpella e Bakiut" i thonë edhe sot e kësaj dite, o bir, o vëlla, o të keqen të marrtë xha Bakiu!"

Një radhë tjetër më tregonte xha Bakiu: "Vetëm ai burrë më paska dashur! Vite më parë martuam byazerë e vogël e si mbaroi dasma, nuk shkoi as mot mot e babai na mbledh, thërret e nga vëllazëria. ai vete e me murgën nënë, na mbledh ne djemtë e më pas na thotë se sa jam gjallë unë, dua ti ujtis këto punë me lezet, të mos më qeshë botë, se po u bënë dy nuse në një shtëpi, ngelet shtëpia pa fshirë, prandaj kam vendosur që në të gjallë tim t'u ndaj, secilit në punët e hesap të vet, se ndarjen e ka dhënë Perëndia e, allaversën, të shtoheni e shumoheni si ble-ta, një mëhallë!"

Ë mirë, dakord ishim edhe ne. Më tej babai me atë rrethin e vëllazërisë i dhanë "karar" kësaj punës së ndarjes, për hisen e gjënë e gjallë në kokë, për njëri e tjetrit me radhë. Mua më ranë gjë e gjallë, tre kokë dhi, mushka e një lope. Nuk shkoj shumë kohë e bije ujku në mal, pikërisht në atë tufë që kisha bashkuar ato dhinë e mia me nja dy fshatarët e mi. Do ti që në ato 7-8 krerë që çau ujku, ishin dhe ato të tria, dhinë e mia. "Epo i çau, i çau, më to qoftë", thashë. Në krye të muaj më trembet mushka dhe shpohet në bark nga një vastarkë e latuar, bëra sa munda po nuk i bëmë dot derman, ju infektua plaga e ngordhi e bekuara. Më bëri qeder të madh, më preu krahët. Tashi mbeçë me atë bisht lope që bënim hall, për një pikë dhallë. E tërë ne, unë me gjithë gruan e fëmijët te ajo i kishim sytë. E marr një ditë e shkoj atje nën atë grendë të Kozicit me një rrëpirë, ish një mezhde e pakullotur. Unë e drejtova atje, po seç shkanë ca gurë nga lagështia e motit. Kur ç'të shoh, o i varfër, lopa u gremis e vetëm kur e pashë në xhade të bërë dërmë nga shembja e rënies nga 100 metër lartësi. Arrita me gjysmë fryme, po kot nuk bëhej, prandaj ia hoqa kokën me latoshkën, s'kisha çfarë të bëja tjetër. Nuk thonë kot, kur s'do, s'do, hapi derën së keqes!"

Në këtë rahman, arritën e nja dy fshatarët e mi, më ndihmuan e ropëm e ngarkuam në dy hajvanë dhe e suallëm në shtëpi. Aty e premë e ndamë copë copa e ndërkohë çatisën njerëzia nga vëllazëria, madje i tërë fshati e ashtu si e kemi ne për të ndihmuar, secili mori nga 2-3 kile mish edhe si për ndihmë, si për të më axhetisur, për të zbutur e këtë zarr të madh që më ndodhi. Në këtë kallaballëk të ardhurish, dikush më thoshte "Obo-bo, o Baki, ç'të ndodhi, të thau krahun, të la fëmijët pa një pikë dhallë. I gjeri ti, i vafëri ti!", e kështu me radhë. Mua të më shponje me thikë, nuk më kish ngelur pikë gjak. Më dukej sikur më kish ndodhur ndonjë xhenaze në shtëpi e isha bërë zehër e vrer fare. Në këtë kohë më vjen një shoku i babait e ai, si mori nja dy kile mish, m'u afrua mua e më tha: "Po ti ç'je bërë më këtë ditë? Thirri mendjes, eja në vete, se nuk ka rënë qameti mbi ty" Ti shiko të më kesh mirë atë "pëllumbeshën" dhe ty, të të rrojnë e të më kesh shëndoshë, ato bir "hallate", more vesh, pa të

tjerat shkojnë e vijnë, rregullohen! Unë kur i dëgjova këto fjalë nga goja e tija, më erdhi rrotull dynjaja, e ment juu ktheva paq e nuk i lashë llaf pa thënë: "Si more ti të tallesh me mua, hatëri që je shoku i babait, se për Perëndi, ta rrëfenja unë qefin!" Ai ndaloi, më pa e tha; "Bëj si të duash, unë ç'pata për të thënë, ta thashë!". Më pas unë nuk i fola atij, as edhe kur vdiq nuk i shkova në varrim. Mirëpo vitet shkuan dhe unë, shyqyr Zotit, u bëra me tërë të mirat, më mall e gjë, me shtëpinë plot me djem e çupa, nipër e mbesa, po vetë u mplaka e sot e kësaj dite sa herë më pjek puna, që shkoj në varret i shkoj te koka e i ndez një cigare duhan e i thom: "Vetëm ti, o Ali, më paska dashur vërtet! Ma bëj hallall!!"

A mor bir i babait, do ta marrish vesh, më vonë, për kë "mëz" e ka fjalën ai!

Vitet ikën, rrodhën shpejt e çupës së martuar me Shefqetin, djalin e xha Mekes, iu ritën fëmija, iu bënë burra për të martuar. Dhe Shefqeti, në dasmën e djalit të madh Zaimit, dërgon Krushkë të parë për të marrë nusen të gjyshin e dhëndërit, xha Bakinë. Me rrethin që kishin caktuar krushq, për të shkuar të marrin nusen në Hondisht të Mokrës në fisin e Ajdinollëve. Kushqit nga Dunica, kuajve përprjetë arrijnë në luadhet Komckë, marin kanalit e ia mbërrijnë në Hondisht, te krushku i ri, të cilët dualën e i pritën krushqit i nderuan, i uruan mirëseardhjen dhe më pas i drejtuan në konakun e miqve. U pritën sipas rregullave e zakoneve të Mokrës. Për të përhëndetur me pas vjen e Krushka e ëma e nuses, ajo si i takoi e u përhëndet me të gjithë u përqendrua te xha Bakiu si krushku i parë, më kryesor e më i vjetër dhe fillon e pyet për të gjithë pjesëtarët e familjes e ndalet e pyet për zonjën e Bakiut si është ajo me shëndet? Dhe ai ju përgjigj se ajo shyqyr deri tashi mirë është me shëndet, ajo ma kalon mua. Jo xhanëm tha krushka, ç'është kjo, edhe juve shumë mirë mbaheni. Jo moj, krushkë, jo! Unë kam rënë, nuk jam si më parë. Jo, mos u qaj se mirë je, çfarë ke? Si ndjehesh, të dhëmb vetëm? Po ja moj krushkë të të rrëfej drejt vetëm ty, meqenëse do ta dish zotrote. Para 2-3 muajsh korrëm ato thekrat e mbjella andej nga mali, po mori koha keq, me shumë lagështi e unë si i bëra duaj i bëra kapule e më tej i ula te shtëpia. Një ditë para ca kohësh, bënte një mot i mirë e unë i them plakës, moj grua rrimë që rrimë, pa shtroje atë lëmë ti, e ti hy unë këtyre duajve më "kalën" e ta bëj e kaq punë që na ka mbetur pa bërë. Dhe ajo më dëgjoi e shtoi lëmën. Unë mora kalin e hyra në lëmë, po do ti, moj Krushkë, si ore ra kali në lëmë, u prenë gjunjët fare, nuk bëhej më i gjallë fare. Unë i dhashë e i mora bot e bot me të mirë e bot të keq po nuk dëgjonte. U nxeha sa më s'bëhej më, e i them plakës të më silltë drapërin se do t'ia prisja kokën kalit! Ajo u shqetësuar, si u bë kjo punë, ardhni e pashë që kish rënë dhe ajo në mejtim. Pse mendohesh, i thashë? Më pas e mblodhi mendjen e m'u dërtua: More plak, si nuk të vjen një çikë gjynah ty për "kalën", na ka shërbyer 50-60 vjet, mos na fut në gjynah se do na dënojë Perëndia, ja deri këtu ka vajtur puna! S'paska më keq, moj krushkë! Ja kështu, mirë e kanë ata që thoshin se burri ka dy vdekje, kjo vdekja e burrit më të gjallë qenka shumë keq. Iku krushka, pa pyetur e pa e zgatur më, duke se e mori të plotë sqarimin që i kërkoi Krushkut! Xha Bakiu tha: "Mos e prisha gjëkund?!" (vijon në numrin tjetër)

Istref HAXHILLARI

Pengu i nënës

Kur motra doli te porta e shtëpisë, në krye të shkallëve u shfaq një flutur krahëshkruar me vija delikate ngjyrëgruri, e ëndërrt si magji. Ende rrotull, luante me dritën që gurgullonte nga kuadrati i derës, bariste andej - këtej mbi kokat tona sikur donte të shprehte diçka me lëvizjen e krahëve. Motra mbajti frymën e zverdhur dyllë.

- Tataja - belbezoi ngadalë e mallëngjyer. Lot të kristaltë i vezulluan nëpër faqet e rreshkura. U kthye sërisht në shtëpi e patakur, e përballuar.

-Do të rri edhe pak, - psherëtiu e ngashëryer përmes lotëve, - ndoshta m'është ngaqë jam vonuar shumë, duhet të vij më shpesh në shtëpinë e saj.

U kthyem brenda. Derën e lamë hapur.

Flutura hyri menjëherë pas nesh, përshkoi korridorin e gjatë shpenguar si e shtëpisë. Çuditërisht njihte çdo qoshe e pengesë. Flatronte e malluar, cekte sende të njohura, tundte krahët e gëzuar nëpër kuzhinë. Qëndroi mbi perden e dritares së lumit. Kthente kokën nga dhoma, pataj vështronte ngultas shtratin e ujit, matanë ballkonit. Në dhomë sundonte heshtje e thellë misterioze, dëgjoheshin fëshfëritjet e lehata të flatrave si muzikë e ëmbël pikuar prej qjellit. Cak i pabesueshëm, i pezull mes dukjes dhe ëndrës, nuk shprehej dot me fjalë. Nemitur, të mallëngjyer, vështronim turbull dhëmbshurisht. Cipa e hollë e plagës së vjetër u çua, gjaku zuri të rridhte me buri. Ndjenim trupat e mjegulluar të rrëshqisnin nëpër kujtime. Përfjetim të pafundme, copëza nga jeta e nënës gurgulluan si lumë i rrëmbyer pas shirave litar të pranverës.

Zemra m'u mblodh lëmsh. Dhjetë vjet! Si ndrydha aq gjatë mallin përvëlues, durova rrjedhën e kohës pambarim? Flutura bariste nëpër shtëpi e patrazuar, mpikste ligështinë, derdhte vetëm kujtime. Oh, sa shumë përfjetim tretur nëpër kohën e thinjur! Edhe vetë erdhi si kujtesë e viteve të përlargta, ndoshta për të kallzuar historitë e fëmijërisë që nuk mundi apo nuk pati kohë t'i përfundonte atëhere. Rrëfimet e ujshme të nënës, zëri i ëmbël, vështrimin magjik i syve kaltëroshë, buruan zhurmshëm të kristalta, të qashtëra. Sa do të doja t'ja puthja tani kësaj fluturze hyjnore syçkat e vockëla si atëhere!

Trupmesatar lidhur mirë, e drejtë selvi si emri i hijshëm Selviko, Tataja dinte të fshehta mahnitëse. Sikur mbartte në eshtra, gjak e mish misteret e kohës, që nuk thuhet me fjalë as shterohen në një jetë. Zotëronte në majë të gish-tave historinë e afërt dhe të largët zhytur pa kthim në humbellë e moteve. Çdo arë, mal, qoshe, rrugë mbushur dëngëz me ngjarje. Si qenë më parë dhe si davaritën nëpër vragët e spërdredhura të kohës. I kujtohej ku e pati shtëpinë xha Seli dhe si e ndërtoi më vonë. Aty mbi përrua patën mbirë kushedi qëkur dy kulat e Jasharit. U shembën kur erdhi uji i rrëmbyer për qamet, i përllau si të mos qenë kurrë. Mbante mend motin e frëngut, luftën e Tesnëve me të huajt që deshën të çnderonin Nadiren, çupën më të nurshme të fshatit. Ndërmendte çdo varr të vjetër, sheshuar prej kohës se njerëzia i patën lënë mënjane, harruar pas punëve të shumta.

Eh! Sa shumë dinte nëna ime e mençur, zonjë e vërtetë. Gratë e thërrisnin hanko Selviko, burrat zonjë, fëmijët tata. Pushteti i saj shtrihet natyrshëm në gjithë shtëpitë e fshatit, përshkonte njerëzit, muret, sendet me forcë të habitshme. Rrëfimet e nënës mbanin aromën e barit të kositur në livadhe, lëndinave ku pluskonte era e luleshtrydheve, dherit këthyer nga parmenda. Zëri melodioz sillte këngën e përrnjëve malorë pranverës gufuar nga bora e shkëritë. Shijojta nurin e rrëfimeve, habitësia nga rridhte magjia e tyre. Tani e di. Veshi i virgjër, pa vvarë nga muzika artificiale, dëgjonte pipëlimën fluide të vesës, flatrimin mitologjik të zogjve, syri i saj shquante elementet fillestarë të natyrës, pashprishur nga dora e njeriut. Shpirti delikat që nuk e njihte zilinë, dhunën, lakminë pikaste meditimin e pyllit në ag, gjuhën e zogjve, dëshirat e njerëzve të thjeshtë. Bijë e dheut, ajrit dhe ujit, e ndiente ku fshihej e vërteta e kuptimit të delirimit të botës.

I mbaj mend një për një si atëhere përballat e çuditshme me xhinde, sprija, diva, botën e poshtme të vdekatarëve, legjendat, histori trimash me kapedanë dhe komitë. Personazhet fantastike lëvriin nga Valamara e Guri i Kamjes në katakombet e Malit të Thatë, nga brigjet e rrëpirta të Shkumbinit në Liqenin e Ohrit, shoqëruar me zërin ngashënjës të Tatasë. Kur nxitonte, zënë me punë pafund, stiste shpejt e

shpejt rrëfenja të reja ose fillonte nga e para të vjetrat. Thartohesha, i prisja fjalën, vazhdoja vetë deri në fund, skinjur nga inati. I thyhej zemra, ndihej fajtoze dhe habitej me kujtesën. Dëgjova t'i shprehej me krenari hallo Hamides: -Gënjeva se më çmendti. Bëra si bëra kurdisa një përrallë. Harrova si përfundonte, më merrej goja, kur ai e vazhdoi gjer në fund. Ke parë kështu malukati?

Qeshi hareshëm çehrehapur plot dritë, me gurgullima të zërit joshës, ashtu si dinte vetëm ajo, derisa i dolën lot nga sytë e hirtë, i dridhej pushi i lehtë mbi buzë. Sa dua tani ta dëgjoj sërisht atë zë, kukurisjen e shpirtit llagar, të shijoj pamjen e ëmbël prej nuseje të hijshme. Nëpër vragat e kohës s'e ngjërvoja kurrë tingëllimën kumbuese, të çiltër si vetë shpirti i nënës. Kushedi sa e kam sëndisur me kuësh-tjen pafund në vrugun e punëve të shumta për të mbajtur shtëpinë e madhe me njëmbëdhjetë shpirt. Kur vija re se pyetjet e mia e çlodhnin nga andrallat e përditshme, merrja kurajë, e ngacmoja për gjithçka. Atëhere vetëm e ndieja, po tani e di shumë mirë sa e mençur qe nëna. Ku i gjente ato fjalë hirplote, prekëse? Si arrinte të shkërbente zërin, shprehet e veçanta të dallueshme për sprijën e ligë dhe të dërguarin e Zotit, ëngjëllin e bardhë që bekonte bukën e njerëzve? Gjuha e saj mbushej me copëza fjalësh tjetërllor nga të përditshmet, krehur çlirët në gojën e gjallesave gjithfarësh. Përvijimet e njerëzve, peizazheve i përcillte me ngjyra misterioze prej ftoi të lulëzuar, molle, qershie, lulekaqesh, qilimi të bletë me bojën e fletëve të ahut. Vështroja pyllin e dendur, drurët viganë dhe përpigësia të merrja vesh ç'të qe kjo bojë e çuditshme, si lyente ahu një më një tërë ato fletë? Ulej në sofa të portës, duartpërvëshur, këmbët tërë baltë nga vaditja me një rrënjë domate dhe preshatkën pranë. Shikonte me dashuri, niste rrëfimin superënduar me zërin e ëmbël mjaltë. Më dukej se i shihte ngjarjet në një kënd fshehtarak ku syri im nuk arrinte. Në vetmi vështroja me ngulm andej nga drejtohej ajo. Hapësirës së gjelbëruar fronin divi katala, e bukura e dheut, ariu i kaftë.

Jetoja krehur në mbresat e rrëfenjave, imitoja pleqtë e mençur, kapedanët, të folurit, sjelljet e tyre. Kështu i mbajta mend tërë jetën pa ditur se do të më duheshin kaq shumë. E shtrënjta nënë më dha leksionin e parë të pazëvendësueshëm të shkrimit. Librat e mij mbajnë hiret e saj, ashtu si i përjetojta dikur. Kur shkruaj ndiej pranë vështrimin e Tatasë, përpigëm të lexoj nëpër sytë blu nëse i pëlqen. Hera herës ata shkëlqejnë plot dritë, atëhere ngutem të mbush faqet njëra pas tjetrës, i gëzuar, i lumtur.

Vitet e fundit banoi në qytet, po shpirti i saj ndodhej larg përreth fshatit, nuk e harroi asnjë çast. Tetë vjet nuk u mësua me qytetin e zhurmshëm, i dukej se ishte larguar për ca punë dhe do të vinte përsëri atje ku i bënte shpirti rehat. Dilte në ballkon, vështronte me vëmendje e durim përtej maleve, kapërcyer vijës së horizontit, njielloj si flutura kundronte tani lumin e heshtur, e menduar. Rrallë vinte re të njohurit e vjetër të zbrisnin rrugën e gjarpëruar anës bregut. Gazmohej, mbushej me frymë, mezi priste të vija. Fytyra i shkëlqente.

-Pashë xha Tekiun, sa ishte plakur! I thirra, nuk më dëgjoi. U çnalla, më solli një copëz dheu poshtë ballkonit.

Atë verë parandjeu fundin e afërt, të pashmangshëm. Kërkoj ta shpinim në fshat ca ditë, të hallastisej me njerëzit, dherin, të linte amanetet. Nuk e tha ashiqare, ndaj s'e kuptova pse deshi të vinte me aq ngulm. Me shkop në dorë, mbështetur krahut të motrës u ra kryq e tërthor udhëve të fshatit. Sytë e trishtë, të ngulit me vezullime kaltëroshë, sodisnin vendlindjen, ku njihte çdo qoshe deri aromën e pemëve, sikur i shihte për herë të parë. Takoi njerëz të njohur. Kudo e pritën me dashuri e nderim tata Selvikon. Qau mbi varret e të parëve, u ngjiti rrëzë maleve, vështroi me dhembshuri të pamatë majat që nuk i arrinte dot. Përmbi Serenivje kishin patur shtatë dynym, e mbillnin thekër. Kur e korrnin rrinte një javë pa vajtur në shtëpi me burrin dhe dy çupat e

mëdha. Tani nuk ngjitej dot ta shihte për herë të fundit. Lot të nxehtë u varën gjer poshtë faqeve bardhoshe, humbën nëpër cullifet e verdha të pabindura.

U ndal gjatë nën arrën e madhe përmbi shtëpi. Trungu qindravçar gërryer nga vitet qëndronte si plak i kërrusur, i mençur që di të kallzojë vetëm rrëfenja të thjeshta. Nën gjethnajtën e pemës së lashtë frynte fllad i ëmbël erëmirë. Kushedi sa herë pati shkundur kokrrat gjatoshme me bukën e bardhë fshehur nën guackën kafe të çelur. Aty kuvendonte mbrëmjeve vonë me gratë. Shumica patën shkuar në pllajën e gjelbëruar, mbushur me tuma dheu, përmatanë lumit të Aradovës. Të gjallat nuk vinin më tek arra. Kush t'i mblidhte?

I përmendi të gjitha me emër. Mbi gurin skrepak rrinte Tikua hokatare me hundën e madhe. Ca më tej ulej ngahera në bisht Këzja surratvare e vuajtur. Rriti djemtë e saj dhe të kunatit. Vetëm djem, asnjë çupë. Me të lara, të shpëlara, duart në ujë i rrinin së varfërës. Pa shiko! Ishka me tërë ato halle vetëm mendohet, sytë e skuqur i mbetën. Burrë sa për të thënë, s'pati fat. Shikimi mori shprehjen e për-vuajtur, ngarkuar me dhimbje për brengat pafund të mikeshës së vjetër. Një e dy yrrshin e mbante te tata Selvikua e gjora. Buzëqeshi dhimbshëm.

- Ah moj Sheqere, sa më paska zënë mal-li! - iu drejtua me mend rrënjës së dalë të arrës, ku ajo rrinte përherë e heshtur, - si nuk fole njëherë, po vetëm dëgjo e qesh.

-Tani nuk mundem më, - iu bë sikur u përgjigj Sheqerja.

-Epo s'ke se si, - pëshpëriti zënë në faj.

Si po fliste kështu me gurët, mos nuk qe mirë nga mendja! Pre e vegimit, u çlirua me zor, lëvizti nga vend i saj nën arrë mbi koritën e përmbysur, rregulloi flokët, rënë mbi sy, preku me dorë gurët dhe trunqun sikur përkëdhelte të dashurat, mbledhur aty për hatrin e saj.

-Ndjesë paçin, - foli me zë të lartë, - sa të mira ishin.

Motra e nemitur dëgjonte pa lëvizur kuvendin e çuditshëm. Ndiente shpirtat e malluar të endeshin përfaqar nënës, sikur e përkëdhëlnin me duar prej ajri.

Kur u mbush java nuk më nxinte shtëpia. Përse po rrinte aq gjatë? Ç'kuptim patën fjalët "më çoni edhe njëherë në fshat"? E pamundur të duroja, mora me nxit rrugën përprejtë. Kapërceva bregun në hyrje të fshatit, hodha sytë përreth. Një lëmsh, mbledhur në zemër, nuk më linte të merrja frymë. Parandjenja të turbullta më mbuluan. Mos vajti në varrezat pranë babait dhe nuk më thoshin? Përse kërkonte të ikte? Ngashërimat turbullonin gjykimin, vegime lemerisë faniteshin nga të gjitha anët.

Më në fund pashë siluetën e njohur përfund arës së lumit, zemra më vajti në vend. Me trup të drejtë fidan shkante nëpër arë. Çuditërisht nuk u kërrus kurrë. Floknajtën e verdhë si grurë i pjekur dendurak s'e zaptonte dot shamija e hollë më xhixha. Ndalonte, mbushej me frymë, shikonte vëndthin e dashur cep më cep. Motra mezi e arrinte. Një boshllëk në gjoks m'i mjegulloi sytë. Për herë të parë nuhata të vërtetë e hidhur. Parandjenja nuk më paskësh gënjyer. Tataja linte amanetet. Vështronte brigjet, çukat, dystet ku kishte shkuar jetën, pastaj mermëriste ngadalë. Edhe e kisha edhe s'e kisha nënën, sikur donte të largohej vetë pa e thirrur askush. Nuk durova, u lëshova me vrap, e pushtova, futa kokën në gjoks, mora erën e saj, u drodha i tëri. Ç'bënte kështu, përse donte të ikte?

Pikasi ngërçin, tendosjen drithëruese.

-Po ti çke, ja ku e ke nënën tënde, nuk do të shkoj gjekundi, sa të çmallem pakëz. Këtu kam kaluar tërë vitet e mia. Pastaj u plaka, ku dihet si e ka shkruar Zoti!

Përtej mundësive të mia ja plasa të qarit me dënësë unë, burrë i martuar me tre fëmijë. Si tani përballë fluturës së nënës nuk ndaja ëndrën nga zhgënjërra. U luta i mbushur me brengë, u përgjërvoja:

-Ikim, mjaft sivjet, mot të sjell prap. Nuk rri dot, s'më hyn në sy asgjë, ke shëmtuar sh-

tëpinë.

Nuk i thashë se po të ikte andej nga e thërriste s'di se kush, do të marrosesha, se largimin e saj nuk e përballoja. Mezi durova një javë! S'kishte pse linte amanetet, doja të rronte shumë vite të tjera. Përse të shkente? Mos vallë qyteti e vriste dalëngadalë të ëmbël time leshflori?

E dinte ç'ishte për mua dashuria e saj. Ende kërthi, u qasa dikur buzë varrit. Kartë cigareje, me damarët mavi kërcyer mbi lëkurë. Të gjithë ma hoqën fillin, vetëm ajo e qetë. Nuk do të vdesë, u tha motrave të zymtuara. Siguria e saj u dha forcë, e dinin do të bëhej si thoshte Tataja. Pse qe aq e sigurtë? E pashë në sytë e ty, tha më vonë, nuk vuajë nga ndonjë sëmundje. U zemërove se të lashë vetëm atë ditë që mbillnim thekër në Kozic. Mungonte ngrohtësia ime, asgjë tjetër.

Njielloj si atëhere me dhimbte trupi, zjar-mia ndizte imazhe të trishta, tymnajtë të mistershme, as në qiell, as në tokë. Nuk ma prishi, i erdhi keq tek më shihte të mjerë, zverdhur meit. E ndjeva, u thye. Si i pa të gjitha, pa u ngopur dot zbriti në qytet. Në zërin e mekur spikata dëshirën e ndrydhur siç dallohet në sfondin rozë ngjyra gri e sedeftë.

-Eh, o bir, njeriu nuk mund të ngopet kurrë me vendin e tij, sado të përpiqet e mundohet, - më tha e menduar.

Në sytë e bukur me ngjyrë të qiellit lexova pikëllim të pazakontë. Unë e ligështova. Donte të rrinte edhe cazë, nuk qe ngopur me dherin as me kujtimet e të parëve. Egoist i mallkuar e desha të tërën për vete. U ndjeva fajtor.

Mallkuar ai që trishton sytë e nënës!

Flutura nuk afrohej, sikur shihte shtrembër nga mua. A mos iu kujtua ajo ditë? Më mbante mëri se nuk e lashë të çmallej me vendin e saj. Peshova më shumë se kujtimet e shtrënjta. Nuk mundi atëhere, po e shoh, i kam lënë peng të rëndë, nuk e kapërdin dot as tani pas kaq vitesh.

Tataja u shua kur mbushi 77 vjeç. Dy javë më parë u sëmur. Unë dhe im vëlla bënim tregtinë e vezëve. Vonoheshim shumë, nganjëherë deri në mëngjes. Nuk mbyllte sy tërë natën, pothuaj e gdhinte në ballkon, me shikim tretur rrugës së Tiranës.

-Mjaft u sflite do të vinë, - i fliste gruaja.

E shikonte me sy të mekur. Lutej t'i thoshte të vërtetën. Dinte gjë apo ashtu kot për t'i dhënë kurajë? Si priste ca ia kthente:

-Ah moj bijë, nëna mos qoftë kurrë. Ku më ze gjumi, kur nuk e di si janë djemtë? Nënës për keq i vete mendja, pret me zëri të ngrirë. Tjetër gruaja, ajo thotë do të vijë burri të sjellë këtë e atë. Si nuk morën në telefon?

Kur vinim shikonte me mall të parrëfyer, prekte me dorë sytë, flokët, ballin, fuste kokën në gj, merrte erën tonë.

-Bini erë evlat, - thoshte, - s'ka si fëmija, ta dini mirë nuk mund të çmohet kurrë sa i dhembshur është.

Pasi u end për njëfarë kohe në hapësirën e shtëpisë, flutura erdhi, më preku lehtë me krahë në ballë, pastaj u ul mbi flokët e motrës. E menduar, përpëliste krahët, diç desh të thoshte me atë gjuhë memece prej lëvizje flatrash. Motra nuk lëvizte, teksa lotët i mbulonin fytyrën, mjegullonin shikimin. Përmes tymnajtës së atij çasti të pahuar, as në ëndërr as zgjuar, shikoja fluturën mbi leshrat e ngatërruar dhe nuk ngopesha dot. Përse qëndroi gjatë atje? Përse më la pas dore, nuk më donte? Ç'merak i kishte mbetur?

Atë ditë erdhëm afër mengjesit. Tataja na përkëdheli pa thënë asnjë fjalë, mori erën tonë pastaj zuri shtratin për dy javë rrjesht. Nuk bënë efekt ilaçet, ajo sikur qe shumë e hidhëruar. Fillova të shqetësohem, po mendoja seriozisht jetën e saj. Lashë punën, gjeta makinë, e çuam në spital. Mezi lëvizte po unë, i marri, nuk duroja.

-Shpejt Tata, pret makina.

Më shikoi me sy të perënduar, sikur donte të thoshte:

-Nuk mundem, o bir, s'e shikon si jam katandisur?

A thua nuk i kishte dalë ai inat pas dhjetë vitesh? Me siguri po. Tataja u zemërua me mua sidoqë nuk ma shprehu kurrë. Zemra e nënës nuk mund të ankohej për djalin, s'kishte se si. Po atëhere pse nuk më afrohej tani pas kaq vitesh? Mbante mëri?

Brengë e madhe më rëndonte në shpirt. Të mos ishim vonuar atë ditë, Tataja do të jetonte ende. Si nuk m'u dha të merrja në telefon, ta qetësoja, të mos e gdhinte natën në ballkonin e acartë të atij janari të zi?! (vijon në faqen 8)

Spiuni

- Spiuni i Bërzeshës b.p. "Xhami" rekrutuar në vitin 1964, nr rendor 95
- Spiuni i Bërzeshës b.p. "Burreli" rekrutuar në vitin 1970, nr rendor 94 (këta të dy janë vëllezër)

Nga Bedri BLOSHMI

B.p. 'Xhami me operativ Nevit Kasën kush ishte? Në vitin 1964 sigurimi i shtetit përpiquej dhe bënte plane të kapte të arratisurin Bardho Leka. Thonë që Bardho Leka pasi u arratis në vitin 1950-'51, vinte në Shqipëri në fashtin Bërzeshë. Sigurimi e detyroi Gjiskën që çupën e saj të madhe t'ia jepte b.p. "Xhamit" cili

është Demir Blloshmi. Ky i fundit mori përsipër se si mik shtëpie do të merrte vesh se kur do të vinte Bardhoja.

Kjo nuk u realizua pasi Bardho Leka në korrikun e vitit 1968 ndërroi jetë në Prizren. Gjithë inatin e bardhos ia nxorën të birin, Genc Lekës të cilin e pushkatuan më 17 korrik 1977.

Për të mësuar mbi hollësitat që ka shpifur b.p. "Xhami", dhëndri i Gjiskës, lexoni "Fabrikimi i vdekjes" e aty do të gjeni trillimet e b.p. "Xhami".

Në këtë shkrim po botoj edhe ballafaqimin në të cilin Mihane Çerri nuk pranon shpifjet e bëra Demir Blloshmit. Në vijim do të botojmë edhe 40 emrat e tjerë nga fshati për të cilët ka trilluar sërish b.p. "Xhami".

VELÇANAKU QË NXORI XHANDARIN NGA DYQANI I TIJ

Asllan Çela ishte një burrë trim dhe i dashur. Në fshatin Velçan kishte hapur një dyqan dhe me kursimet e tij mori inisjativën që të hapte rrugën nga dyqani i tij për tek Kroi i Madh.

Kryetari i Komunes Velçan, Zenel Beu, nga Plasa, në vitin 1939 erdhi në shtëpinë e Alush Çelës, dhe i kërkoi Asllan Çelën për ta punësuar në Komunë. Kjo nuk u pranua nga Asllan Çela sepse komuna ishte vënë në shërbim të pushtuesëve italianë. Ishte martuar me një vajzë nga një familje patriotike në fshatin Shënpremtë.

Në fshatin Velçan, afër xhamisë ishte komanda e xhandarmërisë së Mokrës. Në rrugën që po hapje po punonin shumë burra, bënin kalldrëm, një xhandar ishte tallur me puntorët. Për këtë Asllan Çela i thotë të mos e përsërisë më këtë e ta kthejë prapë. Xhandari këtë ngjarje ja tregon komandantit të xhandarmërisë Kapter Lamçes, një burrë i madh, i rreptë. Për këtë ai dërgoi kapter Bektashin nga Starova tek dyqani për të marrë Asllan Çelën. Por Asllani i ktheu përgjigje se nuk vij, ai i tha se do të marr forcërisht, dhe mbyll dyqanin.

Pas kësaj vjen me vrap kapter Lamçe, revolen në dorë. Unë isha aty bashkë me Asllanin. Asllani me gjakftohtësi, i ulur në banak, nga sirtari nxori revolverin e tij, bëri një gjysëm hapi e i tha: "dil përjashta nga dyqani im. Kapteri u tmerrua nga kjo, dhe doli jash-të. Mua më tha mbylle derën e dyqanit, u mndova shumë deri së e mbylla.

Kapter Lamçe u tërhoq në drejtim të postës, ndërsa Asllan Çela shkoi në shtëpi e u largua, qendroi tre dite në Debrovë dhe shtatë ditë në Tiranë. Kur erdhi, Kapter Lamçe ishte hequr nga posta e xhandarmërisë së Velçanit dhe ishte caktuar në Korçë, në kufi me grekun.

Një vit më vonë Asllan Çela shkoi në Korçë, për të marrë mallra për dyqanin, atje në Korçë pa se po e ndiqte një civil, dhe ky ishte Kapter Lamçe. Isha bashkë me Asllanin, i cili nuk më lëshonte nga dora. Pas disa lëvizjeve takoi një mikun e tij nga Bërzeshta, i cili i dha revolen e vet Miku nga Bërzeshta shkoi në shtëpi dhe mori një revole tek një mik i tij.

Në drekë, u futën të tre në një lokal, unë, Asllani e miku nga Bërzeshta. Asllani u ul në një vend që të shikonte derën se mund të vinte Kapter Lamça. Pas pak vjen kapter Lamça, u fut në lokal, dhe ngriti duart lart në shenjë respekti, e i dha dorën Asllanit edhe i tha: "Kisha vendosur të të vras, por faji është imi dhe tani do të jemi shokë e miq." Kapter Lamça, në lokal piu një kafe, nuk hëngëri drekë. Kjo ishte sipas zakonit, po ti pije kafënë i falje çdo gjë. Jeta e tij nuk qe e gjatë vetëm 40 vjet, ju muar më 10 qershor 1944, që forcat gjermano-balliste në malin e Gjemthit. Ai është kujtuar nga bashkëfshatarët dhe nga miqtë e tij, ishte modeli i njeriut, me veti të veçanta, i qetë dhe i respektueshëm.

Halit ÇELA

Respekt për shoferin e palodhur Guri Korça

Le t'i kushtojmë pak hapësirë edhe një njeriu të thjeshtë të Mokrës, një shoferi të palodhur që çdo ditë, prej mëse një dekadë e gjysmë, kryen ritualin e përditshëm, nga Debrova në Pogradec, Guri Korçës. U lind në fshatin Baribardhë (Debrovë) më 16 nëntor 1956, në një familje me tradita atdhetare. Mësimet e para i mori në vendlindja, më pas në Slatinë. Që i vogël i pëlqente muzika dhe këngët popullore që këndoheshin në fshat e në familjen e tij. Duke parë aftësitë e tij u dërgua nga kooperativa në disa kurse për fizarmonikë dhe klarinetë. Krijoi një grup të vogël muzikor për sebepe të ndryshme, si dasma, gëzime, mbrëmje etj. Por kohët ndryshuan dhe Guri e pa të nevojshme që të bënte edhe kursin e shoferit. Më pas, që prej vitit 1993 e deri më sot ai vijon pa u lodhur itinerarin e përditshëm, si në dimër ashtu edhe në verë, Baribardhë-Slatinë, Vërrin-Përrenjas - Pogradec. Në autometrin e tij tip benz printer, që merr gati 25 pasagjerë, mëse i përshtatshëm dhe i nevojshëm, aq më tepër që ndikon edhe në çmimin e ulët, mjaft ekonomik, për këta banorë të varfër të zonës. Janë të shumtë ata që kanë udhëtuar me Gurin, më të shumtë janë

ata që e njohin dhe kushdo, si ata që udhëtojnë me Gurin, apo edhe shumë të terë janë të kënaqur, pasi jo vetëm ai u është gjendur në të mirë e në të keq, por edhe i ka respektuar dhe është sjellë shumë mirë me të gjithë, madje edhe me ata që kanë ikur e kthehen herë pasa here apo dërgojnë edhe ndonjë porositi të cilën Guri nuk përton kurrë ta çojë në vend. Ky portret i shkurtër për shoferin e palodhur Guri Korça më sjell ndër mend edhe të tjerë shoferë të zonës, të cilët me përkushtim, pasion e ndërgjegje ët lartë punojnë çdo ditë për të bërë lidhjen e Mokrës me qytetin e Pogradecit e me qytete të tjera të vendit. Të tillë janë Sefer Bufi, Syrja Dervishi, Ylli Qyrku, Pajtim Shuli, Qazim Kapri, Noc Mani, Rolanda Alla, Fatmir Hyka etj. Ata janë arteriet që lidhin çdo ditë Mokrën me pjesën tjetër, që i shërbejnë këtij vendi në kushte shumë të vështira atmosferike por edhe automobilistike, pasi rrugët janë shumë të dëmtuara. Respekte dhe mirënjohje për punën e këtyre shoferëve të palodhur dhe të aftë!

Sami LEKA

PROCES - VERBAL (BALLAFAQIMI)

184

Në Librazhd, sot më datën 29.1.1977, Une Selim Çaka hetu i deges puneve te brendeshme Librazhd bera ballafaqimin ne mes te pandehurve Demir Blloshmi e Mihane Çerri për të eliminuar kontradi që ekzistojne ne themiet e tyre.

Pyetet i pandehuri Demir Blloshmi

Pyetje: A e njifni personin qe keni përpara dhe neqof po si i keni patur mardheniet me të?

Përgjigje: Personin qe kam përpara e njoh, ajo eshte Mihane Çerri, me ate kam kaluar mirë familjariisht.

Pyetet e pandehura Mihane Çerri

Pyetje: A e njifni personin qe keni përpara dhe si k patur mardheniet me të?

Përgjigje: Personin qe kam përpara e njoh, ai eshte Demir Blloshmi, me ate nuk i kemi patur si familje mardheniet te

Pyetet i pandehuri Demir Blloshmi

Pyetje: I pandehur na thoni ç dini për të pandehure:

Përgjigje: Siç e kam shpeguar edhe ne proces verbal mija, une se bashku me Mihanen ne shume raste kemi vjedhir pasuri e Kooperatives, vjedhje te cilat po ja them ne sy.

ne vitin 1975, Mihane Çerri i dha ne prezencen time Rustem dashit 100 kg grurë nga magazina si shpërblim për punen qe ai kishte bere ne ndertimin e shtepise se Mihanes. Qe kebe rast edhe une i nrmova Mihanes dhe Rustemit për te marre giurin. A qene mengjese.

Po ashtu Mihane Çerri, ne nje rast kur une erdha nga zbori vitin 1973 ose 1974, 20 kg fasule, une i dhashe leket. Aty ka qe i pranishem edhe Bedri Blloshmi e Rexhep Sula. Ato fasule une ja lukes për Gjiskan.

Vitin nuk e mba mend por ne nje rast Mihane s une i thashe 50 kg grurë për Gjiskan dhe kjo ja dha Bedriut i cili mi dha mua dhe une ja shpura Gjiskës. Për kete grurë une nuk i kam dhene leke wsi i kisha qare materjal tek shtepia e saj qe po ndertonte.

Mihane me leke ne dore ne magazine me shiti 10 kg arra te cilat une i doja për Gjiskan. Ky rast duhet te kete qene ne vitin 1974.

Mihane ne nje rast ne vitin 1975 une kishah nevoje për qepe dhe ca grurë, meqenese Mihane nuk kishfe ne magazinën e saj me tha qe të shkoja e të merreja ne magazinën e Gurrës. A tha nje deftese dore për magazinjerin, dhe une mbasi mora 50 kg grurë dhe 50 kg qepë i prura megjithe dokumen ne magazinën ku punonte Mihane. Keto Mihane mua mi dha pa leke meqenese une i kisha punuar ne ndertimin e shtepise.

Mihane ne vitin 1974 ne kohen qe grumbullohej grurë tek vatra e kultures, mr dha mua 30 kg grurë për punen qe i kisha bere ne ndertimin e shtepise dhe 60 kg ja dha Bedriut i cili ishte se bashku me mua.

Rustem çerri ne nje rast ne vitin 1974 ose 1975 vinte ne drejtim te magazines me nje ene me 5 kg gaki, u cilen mbasi e syeta me tha se do ta nderronte ne magazine yek Mihane meqenese ishte e butë. Për të mos re ne ne sy ma fha mua, une ja shpura Mihanes-onen me raki kurse me pas ne magazine tek Mihane ka shkuar Rustemi.

ne vitin 1975 kur une punoja ne ndertimin e shtepise time mu mbaruan gozhdet, shkova dhe i kerkova Mihanes ajo medha 10 kg gozhdë 10 ose 11 dhe une i dhashe leket. E dija se keto ajo i pervetonte si ato te parat, por përseri une ja dhashe leket.

Kur i ndihmoja ne nje rast ne bërjen e shtepise i shkova ne magazine, ndjeva eren e rakise dhe i kerkova Mihanes 1 kg dhe kjo ma dha pa leke meqenese i punoja ne shtepi.

Mihane ka marre tek furra e gropës se Biahtogut 2 kv gelqere dhe leket nuk i ka paguar. Kjo edhe ne gropat e tjera ka marre gelqerë po nuk di ne se i ka paguar ose jo.

Kur po i aja lende, ne vitij 1975 Mihane me dha për lenden qe i aja nje kukull 1,5 kg me penje pambuku nga magazina pa leke.

Ali Sina i ka uar ne shtepi 1 kv rrush nga ai i Kooperatives Mihanes dhe di qe kete rrush Mihane e ka bere pekmez.

Bedri Blloshmi me ka thene se i ka mbuluar Mihanes nje defiqit prej 25 kv miser, për kete ai di hollësira.

Pyetet e pandehura Mihane Çerri

Pyetje: Ju i degjuat deponimet e të pandehurit Demir, çfare keni për të thene?

Përgjigje: Une nuk e pranoj demirin për asnje gje. Rustem çashi nuk ka marre tek une grurë kjo eshte genjeshter. Grurë as ketij d dhe as Bedriut nuk u kam dhene tek vatra e kultures. As për Gjiskan nuk u kam dhene grurë, ky genjen. Ne asnje rast une nuk i kam dhene Demirit fasule as me leke as pa leke. Gozhdet i ka marre dhe i ka prurë përseri gozhdë, nuk eshte e vertet se me ka dhene pare. Gozhdet i ka prurë Sherifi Çarra nuk ka patur fare tek une ne magazine prandaj une nuk i kam shitur arra për Gjiskan. Nuk eshte i vertet ti kem dhene kukull peri Demirit falas nga magazina. Nuk eshte e vertet qe Ali Sina te me kete prurë rrush ne shtepi dhe une te kem bere pekmez, ne asnje rast une ne shtepi nuk kam berepekmez. Gelqerë kam marre tere kohen vetem dy kv dhe kam paguar leket.

Pyetet i pandehuri Demir Blloshmi

Pyetje: Ju degjuat pretendimet e të pandehures Mihane, çfare keni për të thene për to?

Përgjigje: Ajo genjen nuk thotë te verteteh. Proses verbal mbasi u lexua e firmosim.

TË PANDEHURIT HFUESI

(DEMIR BLOSHMI) (MIHANE ÇERRI) (LULO YMKRI) (SELIM ÇAKA)

Handwritten signatures and initials.

Polifonia e Rrajcës në Festivalin Ndërkombëtar të Polifonisë Shqiptare "Bylis 2010"

Për tre ditë me radhë, në fillim të muajit qershor, rreth 15 grupe artistike nga rrethe të ndryshme të vendit, por edhe jashtë kufijve të Shqipërisë, u ngjiten në skenën e improvizuar në qendër të qytetit antik, ku nëpërmjet interpretimit të tyre i dhanë jetë e gjallëri jo vetëm kësaj qendre historike por edhe më gjerë. Në ditën e tretë të festivalit u dhanë edhe vlerësimet për grupet pjesëmarrëse. Juria e përbërë nga njerëz të shquar të artit dhe kulturës vlerësuan paraqitjen e grupeve polifonike. Djemtë e rinj të Progonatit, Zëri i bilbilave të Sarndës dhe grupi i Janinës ishin grupet më të duartrokitura të këtij festivali kushtuar muzikës polifonike në rajon.

Ky festival i mbajtur nga 3 deri në 5 qershor, nga Shoqata Kulturore Bylis-polifonia, ngjiti në skenën antike shtatë grupe polifonike nga pesë vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në ditët e festivalit performuan muzikën e tyre nëntë grupe nga Shqipëria, si dhe një grup nga Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia.

Muzika polifonike aq e njohur në rajonin tonë përcolli një atmosferë të



larmishme në qytetin antik, ku në fund të festivalit u zhvillua edhe një simpozium mbi polifoninë dhe ruajtjen e kësaj vlere folklorike shpirtërore të vendeve të ndryshme.

Në këtë Festival mori pjesë edhe një grup polifonik nga Rrajca, i cili u duartrokoi gjatë dhe u mirëprit si nga art-dashësit ashtu edhe nga kritika e specializuar. Pjesëmarrës në këtë grup ishin: Ali Coka, Ramazan Turtulli, Çelik Çani, Lavdim Turtulli, Eriola Turtulli, Bleona Vreto, Silvana Bogdani, Xhovana Ozuni, Artiola Belegu, Elton Turtulli, Flavio Karriqi, Berti Kurti, Valter Hana.

Ky grup i mirënjohur jo vetëm në Rrajcë por edhe më gjerë, gjatë festivalit prezantoi këngët "Behari po vjen, dimri po shkon", ku zëri i parë ishte Ali Coka, zëri i dytë Ramazan Turtulli, shoqëruar nga grupi i burrave me valle të kënduar nga Xhovana Ozuni, Elton Turtulli, , kërcejnë Eriola Turtulli dhe Bleona Vreto. Mbyllja u bë me "Suitë vallesh rrajcare" me instrumentist Ramazan Turtullin, Çelik Canin dhe Lavdim Turtullin. Materiali u përgatit nga Ali Coka, ndërsa menaxher i grupit ishte muzikologu Olsi Turtulli.

Rrajca edhe në Festivalin e Fyejve në Gramsh

Ky festival nuk ishte asgjë të përbashkët me Festivalin që organizoi Qendra Kulturore Gramshit, me drejtoreshë znj. Ledi Shqiponja, më 03./06./2010, një festival kombëtar i fyejve, ku erdhën grupe nga Maqedonia, Kosova, si edhe nga rrethet e tjera të Shqipërisë, një organizim prefekt me kushte hoteli e ushqimi që do ta kishte zili edhe rrethi me i madh Shqipërisë, çdo gjë në këtë festival ishte prefekte.

Lasgushi-poet larg politikës

Nga Zenun FERRO

Lasgush Poradeci, Eqerem Çabejt u shkollua në botën gjermane etje. Një lob progjerman me formim gjerman ose progjerman, kanë qenë Mehdi e Mit'hat Frashërin, arkitekti Karl Gega, Eqerem Çabejt, gjuhëtari më i madh shqiptar, Lasgush Poradeci, poeti At Anton Arapin, dijetari Lef Nosi e etj. Qemal Butka, kreu shtetit 12 vjet në Austri, shkollën e mesme dhe të lartë teknike të Vjenës, ku u diplomua si inxhinier arkitekt. Në Vjenë, veç formimit teknik, Qemali është tepër aktiv ndërmjet studentëve shqiptarë të atjeshëm. Si antar i shoqërisë patriotike Albania, ai bashkëpunoi për botimin e revistave "Djalëria", dhe "Minerva", ku veç tij shkruanin dhe njerëzit e mëdhenj të letrave shqipe Eqerem Çabejt, Lasgush Poradeci dhe Aleks Buda.

Elita e paraluftës, që kishte qenë në një masë të madhe e shkolluar në Austri e Gjermani pas luftës saktësisht nuk ekzistojnë më, prej saj kanë tek-tuk përkthime nga Lasgush Poradeci e Skënder Luarasi (Gëte, Shiler, Hajna), të cilët nuk e arritën të bëhen popullorë. Në vitet 1930-të popullorë u bënë vetëm disa vepra në prozë, edhe ato jo me të rëndësishmit e letërsisë gjermane.

Svajg, Remark, Fojtvanger sajë përkthimit të Robert Shvarcit.

Gjendja nisi të ndryshohet disi në vitet 1980-të kur u bënë të njohura me një pjesë të vogël të veprës së Bertolt Breht, vëllezërit Mann, Hajnrih, Bël, Herman Hese etj. Këto 20 vjetet e fundit kanë sjellë një mori emrash dhe titujsh nga letërsia e gjuhës gjermane, edhe pse më pak sesa nga letërsitë e tjera të mëdha të kontinentit ose letërsia amerikane.

Poeti Lasgush Poradeci ka qenë larg politikës. Në kohën e letërsisë, Lasgushi nuk i thuri lavdi mbretit, si disa shkrimtarë të kohës, por nuk mbeten as me krahun me prije revolucionare ose majtiste. Pushimin e Shqipërisë nga Italia fashiste e priti me urrejtje, për shkak se vendi humbi pavarësinë dhe rreziku i kolonizimit dukej imediat gjatë luftës si mjaft intelektualë të tjerë, qëndroi neutral.



Në kohën e pushtimit ai nuk u vu në shërbime të tjera, edhe pse ata u përpoqën të afronin intelektualët shqiptarë që kishin studiuar në gjermani, ose Austri dhe cilësosheshin me kulturë gjermane. Lasgushi ruajti pavarësisht e tij duke iu kushtuar punëve letrare dhe kulturore. Në kohën e Zogut, u ndez diskutimi i hapur rreth vlerave të Lasgushit si poet. Në revistën letrare "Java" u botua një shkrim kritik në vitin 1937, nga Kris Maloku me titullin dyshues "A është poeti Lasgush Poradeci?" Duke replikuar me Mitrush Kutelin që ngrihte lart meritat artistike të poetit Lasgush Poradeci, Kris Maloku përpigje ta ulte figurën e tij. Prendimet e tij nuk gjetën përkrahës, për arsye të thjeshtë se vëllimi poetik lasgushit "Vallja e Yjeve (1933) dhe "Ylli i zemrës (1937) e kishin lartësuar emrin e tij në shkollën e poetit kombëtar, me motivet dhe gjuhën poetike që solli: Poezia e tij nga çdo anë ishte më moderne, më afër poezisë europiane, se e çdo poeti shqiptar deri në atë kohë. Lasgushi nuk është poet oborri. Për të misioni i poezisë ishte hyjnor, prandaj ai as nuk e konceptonte si mund të shkruante poezi politike.

Nis Festivali "Këngë Jeho" në Strugë

Struga mirëpret festivalin e 19-të me radhë "Këngë Jeho", festival ky që ka për qëllim prezantimin e folklorit, kulturës dhe të historisë shqiptare. "Festivali, i cili është bërë traditë që prej vitit 1992, e ka treguar veten si prezantues të rëndësishëm të vlerave kulturore dhe artistike të shqiptarëve," thonë organizatorët e tij. Festivali filloi mbrëmë me parakalimin e pjesëmarrësve nëpër rrugët e qytetit. Ministria e Kulturës e mbështet financiarisht këtë eveniment, me vetëm 200 mijë denarë. "Me të vërtetë pati një vështirësi të madhe për ta realizuar, por entuziazmi, puna e madhe, dëshira e vullneti i stafit organizues ia arriti qëllimit që Struga sot është në dasmë. Mund të them se përgatitjet kanë qenë në nivel të duhur. Ne presim një festival me vlera të vërteta artistike, por natyrisht kjo varet prej prurjeve që na sjellin shoqëritë e ndryshme nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi", thotë Zini Jusufi, drejtor i festivalit. Në festivalin Këngë Jeho, marrin pjesë 17 ansamble folklorike nga shumë qytete të Maqedonisë por edhe nga Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi me rreth 500 folklorist. Gjatë viteve të kaluara në Strugë, të pranishëm kanë qenë edhe pjesëmarrës nga disa shtete evropiane, madje edhe nga Amerika ku jetojnë plot emigrantë shqiptarë që ende ruajnë dhe kultivojnë folklorin dhe kulturën shqiptare. Në festival, ndër të tjera do të prezantohen edhe veshjet tradicionale të shqiptarëve. "Është një festival ballkanik për shqiptarët, pasi që I bëri dy dekada që ekziston ndërsa sa I përket anës organizative ose pjesëmarrjes, d o ët kasha thënë se ende jemi në fazën fillestare. Unë mendoj se Ministria e Kulturës duhet të jetë më syçelë sidomos politikanët tanë që janë në qeveri", thotë Sadik Emro, folklorist nga Kërçova. Festivali, sikurse deri tani, nuk ka karakter garues, por vetëm promovim të traditës. Koncertet mbahen në sheshin e qytetit të Strugës.

Pengu i nënës

(vijon nga faqja 6)

Rrija pa lëvizur mos trembja fluturën e bekuar. Pa fjalë i lutesha të vinte drejt meje se më kishte marrë malli shumë. S'qenë pak dhjetë vjet pafundësisht të gjatë. Ajo nuk ma ktheu kokën. Puhiza e lehtë e krahëve lëkundte një fije floku të motrës, kredhur në pikëllim tron-ditës. Ndonëse mundahej ta mbante veten, ngashërehej fort, padashur e lëvizte kokën, po flutura nuk largohej. Përkëdhelte butësisht leshrat sikur donte ta qetësonte, t'i shterte lotët.

Zot o Zot, a mund të durohej gjer më kaq?!

Si nuk më shkoi mendja ta çoja më parë të mjeku, kur mundësia e shpëtimit ekzistonte ende, po e lashë aq vonë? Punët e përditshme më shtynë ta vonoja me sot me nesër vizitën derisa nuk pati asnjë vlerë. Nuk tha kurrë sa e sëmure që, vetëm shikonte me sy të perënduar. Nuk e kuptova? Jo, mizorisht isha i pandjeshëm ndaj dhimbjeve të saj. Si nuk e mendova Tatanë plakë, të pafuqishme, si nuk iu gjenda pranë në vrangën e plumbtë të sëmundjes së mallkuar? Vonë, tepër vonë e çova te mjeku. Shoku im i dashur, Kimi që nuk jeton, më tha atëherë:

-E le pas dore Tatanë, që e doje aq shumë.

E shikova me ngulm. Sytë e çiltër thoshin të vërtetën. Dhjetë vjet kam mbajtur mbi shpinë barrën e rëndë të fajit, kam qarë, kam thirrur si i marrë, kam përplasur kokën pas murit ku mbështetej Tataja. Të gjitha pa dobi. Guri i fajit fundosi brenda meje, plaga zuri kore dhe unë u qetësua disi. Po ja u shfaq flutura e nënës dhe m'u rikthye si atë ditë të plumbtë janari pesha e fajit të riparueshëm.

E nxorrëm nga spitali. Nuk e mori veten, çdo ditë ligje e tretej, vetëm tretej e tretej. Rrija orë të tëra, i flisja. Nuk përgjigjej, vetëm shikonte me sy të perënduar. Si nuk i kërkoja falje për atë vonësë të mallkuar?

Dy ditë para fundit u bë keq. Lajmërova motrën e madhe në Tiranë. Tataja më shikonte kur i thoja po vinte. Lëvizte sytë me zor, frymëmarja ju vështirësua shumë. Ndoshta do të firon-te atë ditë sikur t'i kishte ardhur çupa e Tiranës. Nuk mund të shuhej pa parë edhe njëherë të gjithë fëmijët e saj, sidomos atë që e kishte larg.

Rrotull shtatit rreshtuar shtatë fëmijët e saj. Pikëlluar, vrerosur, prisnim me tmerr fundin e nënës. Motrat qanin në heshtje fsheshtas, i druhashin syve të kaltër, aq shumë të dashur, të shtrenjtë përtej çdo kufiri.

-Dhimbja e Tatasë është e madhe, - tha motra e dytë, - po ndahet nga të gjithë fëmijët, s' do të na shohë kurrë. Ktheu kokën mënjatë me tmerr, e lemerisur, u largua me nxit nga dhoma.

Ajo shprehu atë që mendonim të gjithë po asnjë nuk guxonte ta thoshte. Pas atyre fjalëve humbi çdo shpresë që na mbante deri atëherë. Motrat e përlojura largoheshin një nga një, qanin me zë diku tjetër. Tataja i shikonte, kuptonte gjithçka. U ngrit përmbi dhimbjen e trupit me stërmundim.

-Mos ikni, - tha ngadalë me ndërprerje të frikshme të zërit, - dua t'u shikoj, s'kam kohë. - Një ditë do të shkoja edhe unë, si të gjithë. Tani është çasti im.

Kalo i shikimin e dhembshur të syve bojë-qielli me radhë nga motra e madhe përfundoi te vëllai, fëmija i fundit.

-I vogli i nënës, - regëtiu të mbramen herë dhe mbylli sytë për të mos i hapur më.

Ata sy që i njohim aq mirë, vështrimin e dhembshur jetëdhënës të nënës nuk do ta ndjenim kurrë. Të qarat mbuluan shtëpinë si kumt i llahtarshëm.

Flutura u ngrit erdhri rrotull nëpër shtëpi, më preku lehtësisht në faqe dhe u largua pa kthyer kokën. M'u bë sikur iku për herë të dytë Tataja nga ajo derë logoritur me lotët e shtatë fëmijëve të saj. Plaga e dhimbjes dhe fajit të gurtë u hap, zuri të kullojë gjak. Motra m'u hodh në qafë, më shtrengoi fort. Pushoi dënesat, më fshinte me duart e dritëhura faqet e lagura. Sytë i mbante nga dera e hapur, ku luhati krahët për të fundi herë flutura bojëgruri e nënës.

-Tatanë e zuri malli për ty, shtëpinë ku pleqëroi dhe kujtimet e jetës mes nesh. Po të që zemëruar nuk do të vinte.

Kujtoi së më fashiti plagën, por u trazova tejet shumë, u plasa në dyshemenë e kuzhinës dhe qava gjatë. Trupi më dridhej nga e keqja. Nuk e di a më zhbregosi Tataja në këtë ardhje të beftë në shtëpi? Më fali vallë?

Motra më përkëdhelte me dashurinë e saj dhe nënës, përzier së toku.

Istref Haxhillari
Pogradec, e hënë 31 maj 2010